

**VENDIM**  
**Nr. 408, datë 27.6.2012**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË**  
**PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR**  
**BULEVARDI “BAJRAM CURRI” DERI NË RRUGËN “ALI DEMI”,**  
**FAZA E DYTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë truall dhe objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”, faza e dytë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- për sipërfaqen 930 (nëntëqind e tridhjetë) m<sup>2</sup> (tokë truall), me vlerë 27 740 970 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e dyzet mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekë;

- për objekte me sipërfaqe 767 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m<sup>2</sup>, me çmimet e konfirmuara prej ZRPP-së, me vlerë 94 987 734.4 (nëntëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 445 000 (katërqind e dyzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Bashkia e Tiranës.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 122 728 704.4 (njëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e katër pikë katër) lekësh të përballohet nga Bashkia e Tiranës, prej fondit të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Tiranës.

6. Për pasurinë nr. 8/507, në pronësi të bashkëpronarëve Burreli, të bëhet likuidimi pas paraqitjes së dokumentacionit të pronësisë, si dhe pasi të jetë liruar prona nga barrët përkatëse hipotekore, fakt, i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga ZVRPP-ja.

7. Për pasurinë nr. 8/271, në pronësi të bashkëpronarëve Puci, të bëhet likuidimi pas mbarimit të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP dhe pas paraqitjes së dokumentacionit të plotë të pronësisë, me të gjitha të dhënat, sipas listës bashkëlidhur.

8. Shpronësimi të fillojë më 1.7.2012.

9. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë së Tiranës.

10. Bashkia e Tiranës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas pikave 6, 7 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Bashkia e Tiranës dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

12. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**